

## Informacione mbi

# PASAPORTA FAMILJARE E LANDIT

### ÇFARË ËSHTË PASAPORTA FAMILJARE E LANDIT?

Pasaporta familjare e landit u krijua në vitin 1979 në kuadrin e një programi për mbështetjen e familjeve. Ajo është e pavarur nga të ardhurat dhe një ndihmë vullnetare e landit.

### PËR ÇFARË SHËRBEN PASAPORTA FAMILJARE E LANDIT?

Me pasaportën familjare të landit dhe me kuponin e përvitshëm përkatës familjet aktualisht mund të vizitojnë deri 20 herë falas ose me një hyrje të reduktuar në objekte argëtuese të tilla si kështjella, kopshte ose muze në të gjithë Baden-Vyrtembergun.

### KUSH MUND TË APLIKOJË PËR PASAPORTËN FAMILJARE TË LANDIT?

Pasaportën familjare të landit mund ta marrin:

- o Familjet me të paktën tre fëmijë me të drejtë për para të fëmijëve, të cilët jetojnë me prindërit e tyre në bashkësi familjare,
- o Familjet me vetëm një prind, të cilët jetojnë në bashkësi familjare me të paktën një fëmijë me të drejtë për para të fëmijëve,
- o Familjet me një fëmijë me të drejtë për para të fëmijëve me aftësi të rëndë të kufizuar,
- o Familjet që kanë të drejtë për mbështetje papunësie (Hartz IV) ose për para të fëmijëve dhe jetojnë në bashkësi familjare me të paktën një fëmijë me të drejtë për para të fëmijëve,
- o Personat me të drejtën për para banese,
- o Familjet që marrin ndihma nga Ligji për azilkërkuesit i Gjermanisë (AsylbLG) dhe jetojnë në bashkësi familjare me të paktën një fëmijë.

### KUSH MUND TA PËRDORË SË BASHKU ME FËMIJËT PASAPORTËN FAMILJARE TË LANDIT?

Në vitin 2019, pasaporta familjare e landit u orientua edhe më mirë ndaj nevojave të familjeve dhe fëmijëve të tyre. Tani, në pasaportën familjare mund të regjistrohen, krahas një fëmije, deri në katër të rritur, si për shembull një prind biologjik i fëmijëve që jeton i ndarë, gjyshja dhe/ose gjyshi ose një shoqëruar i familjes. Deri në këtë moment, ata ishin të përjashtuar nga ndihmat e pasaportës. Në këtë rast, gjatë eksursioneve, prej personave të regjistruar mund të përfitojnë nga favorët e pasaportës familjare të landit dy të rritur së bashku me fëmijët. Kushtet bazë për marrjen e pasaportës familjare mbeten të njëjta. Një përfitim pa fëmijë (t) nuk është i mundur.

## KU MUND TA MARR PASAPORTËN FAMILIARE TË LANDIT?

Për pasaportën familjare të landit mund të aplikoni pranë Zyrës së Kryebashkiakut të bashkisë së vendbanimit tuaj. Atje ju merrni gjithashtu edhe informacione të tjera.

## PËR ÇFARË MË NEVOJITET KUPONI PËR PASAPORTËN FAMILJARE TË LANDIT?

Kuponi që merret i ri çdo vit pranë organit përgjegjës të qytetit ose bashkisë suaj përmban marka me vlerë për institucione shtetërore dhe joshetërore si dhe të gjitha ofertat e tjera.

Duke paraqitur pasaportën familjare të landit ose kuponin, së bashku me fëmijët tuaj mund të vizitoni kështjellat dhe kopshtet shtetërore si dhe muzetë shtetërore të Baden-Vyrtembergut ose edhe një nga ofertat joshetërore falas ose me një hyrje të reduktuar.

Kuponat e përshkruar në mënyrë të veçantë japin të drejtën për një hyrje falas ose të reduktuar në institucionin e shënuar. Me kuponin "Sonstiges Objekt" (objekt tjetër) ju mund të vizitoni falas kështjella, kopshte dhe muze të tjerë shtetërorë, edhe disa herë në vit.

Në rastin e eventeve të veçanta, ju lutemi të informoheni paraprakisht nëse edhe atje hyrja është falas.

## A MUND TË VIZITOHEN OFERTAT EDHEPA KUPONA?

Me paraqitjen e pasaportës familjare të landit ju mund të vizitoni falas edhe oferta të shumta. Këto ju i gjeni në listën të institucioneve joshetërore në faqen tonë zyrtare të internetit. Më poshtë disa shembuj:

- o Oberrheinische Narrenschau
- o Kështjella Waldburg
- o Muzeu i bizhuterive Pforzheim
- o Muzeu kombëtar dhe i leterërsisë moderne Shiler
- o Pjesëmarrje në guidën historike të qytetit Esslingen dhe në guidën e qytetit Besigheim
- o Muzetë Kraichtaler
- o Qendra e formimit të historisë natyrore Ulm
- o Muzeu i romakëve Güglingen, so dhe shumica e monumenteve dhe muzeve letrare.

## ÇFARË ËSHTË TJETËR E RËNDËSISHME?

Ju sugjerojmë që të informoheni paraprakisht në internet ose me telefon pranë ofruesve përkatës lidhur me orarin dhe çmimet e hyrjes.

Një listë të kështjellave, kopshteve dhe muzeve shtetërore në Baden-Vyrtemberg si dhe një listë të ofertave joshetërore e gjeni në faqen zyrtare të internetit të Ministrisë për Çështjet Sociale, të Shëndetit dhe Integritimit në: [www.sozialministerium-bw.de/landesfamilienpass](http://www.sozialministerium-bw.de/landesfamilienpass)